

**VENDIM**  
**Nr. 450, datë 26.7.2018**

**PËR BASHKËRENDIMIN DHE KOORDINIMIN E PROCESIT TË INTEGRIMIT  
EVROPIAN, NDËRMJET QEVERISJES QENDRORE DHE NJËSIVE TË  
VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “c”, 10, 11 dhe 12, pika 3, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e strukturës së integrimit evropian në çdo bashki, si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, brenda strukturave të tyre administrative ekzistuese, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

2. Përgjegjësitë e strukturës së integrimit evropian që krijohet në bashki janë si më poshtë vijon:

a) Bashkërendimi dhe mbështetja e strukturave administrative të bashkisë për zbatimin e politikave, të legjisllacionit, të investimeve dhe të shërbimeve të lidhura apo që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian, në nivel vendor;

b) Bashkërendimi i strukturave administrative dhe përfaqësimi i bashkisë në marrëdhënien me strukturat e qeverisjes qendrore përgjegjëse për integrimin evropian dhe proceset përbërëse të tij;

c) Bashkërendimi i strukturave administrative të bashkisë për rritjen e kapacitetit përthithës të përdorimit të asistencës së Bashkimit Evropian për procesin e integrimit evropian në nivel vendor;

ç) Bashkërendimi, organizimi dhe drejtimi i aktivitetit publik të bashkisë, me qëllim realizimin e funksioneve të veta apo të deleguara në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe të zbatimit të asistencës të Bashkimit Evropian për këtë proces;

d) Mbështetja dhe drejtimi i strukturave administrative të bashkisë për përgatitjen, zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe informimin për projektet e financuara nga programet e asistencës së Bashkimit Evropian për procesin e integrimit evropian në nivel vendor;

dh) Hartimi çdo 6 (gjashtë) muaj ose, nëse kërkohet, sipas rastit, për të informuar Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, lidhur me përmbushjen e kriterëve dhe të standardeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian dhe/ose zbatimit të asistencës së BE-së, për funksionet e veta apo të deleguara të bashkisë;

e) Informimi në mënyrë periodike i publikut dhe i grupeve të tjera të interesit për procesin e integrimit evropian, për politikën e BE-së dhe mundësitë për përfitim nga asistencën e Bashkimit Evropian, nëpërmjet këndeve të Bashkimit Evropian, të cilat krijohen dhe funksionojnë brenda bashkisë;

ë) Administrimi dhe publikimi i informacionit rreth Bashkimit Evropian dhe procesit të integrimit evropian të Republikës së Shqipërisë, në faqen zyrtare të internetit të bashkisë, informacioni i cili duhet të ketë formë dhe përmbajtje të unifikuar për të gjitha bashkitë;

f) Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit Evropian, me mbikëqyrjen dhe mbështetjen e strukturave të Koordinatorit Kombëtar të Instrumentit të Parazgjerimit (NIPAC).

3. Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me/dhe me drejtimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, mbështet, koordinon dhe monitoron forcimin e kapaciteteve të bashkive për përmbushjen e kriterëve dhe të standardeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian për funksionet e veta apo të deleguara të bashkisë dhe ka këto përgjegjësi:

a) Monitoron në mënyrë periodike përmbushjen e detyrimeve nga bashkitë, lidhur me ngritjen e strukturave të integrimit evropian dhe performancën në zbatimin e funksioneve të tyre, sipas

përcaktimit të këtij vendimi;

b) Monitoron, mbështet dhe koordinon punën për zgjidhjen e problemeve të hasura, nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, me qëllim funksionimin e strukturës së integrimit evropian në çdo bashki;

c) Mbështet bashkinë në përcaktimin e fushave, prioriteteve dhe/ose çështjeve ku duhet të orientohet kërkesa e tyre për asistencën e Bashkimit Evropian;

ç) Bashkërendon me bashkitë procesin e vlerësimit kombëtar të performancës së tyre mbi plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian;

d) Analizon zbatimin e masave për realizimin e agjendës së integrimit evropian në nivel vendor dhe ndikimin në lidhje me procesin e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

4. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme mbikëqyr, jep orientim strategjik dhe informon mbi procesin e integrimit evropian dhe politikat e programet respektive, të cilat mund të zbatohen në nivel vendor dhe ka këto përgjegjësi:

a) Siguron pjesëmarrjen e përfaqësuesve të njësive të vetëqeverisjes vendore në forumet apo strukturat konsultuese për procesin e integrimit evropian dhe të asistencës së Bashkimit Evropian për këtë proces;

b) Bashkërendon punën me Ministrinë e Brendshme dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, lidhur me asistencën dhe mbështetjen e bashkive në procesin e forcimit të kapaciteteve të tyre për procesin e integrimit evropian;

c) Informon mbi asistencën e Bashkimit Evropian për procesin e integrimit evropian, përfshirë programet nga të cilat përfitojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore;

ç) Informon bashkitë lidhur me hapjen e thirrjeve për propozime, në kuadër të programeve të ndryshme të financuara nga Bashkimi Evropian, nga të cilat përfitojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore;

d) Mundëson konsultimin e bashkive në lidhje me procesin e aplikimeve, duke shërbyer njëkohësisht si pikë lidhjeje e tyre me strukturat përkatëse të menaxhimit të programeve të financuara nga Bashkimi Evropian;

dh) Mbikëqyr kapacitetin dhe masën e përthithjes së asistencës së Bashkimit Evropian nga bashkitë.

5. Ministrinë janë përgjegjëse për sigurimin e informacionit të nevojshëm për problemet sektoriale që lidhen me zbatimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian, sipas sektorëve që mbulojnë dhe në përputhje me funksionet e bashkive dhe kanë këto përgjegjësi:

a) Të caktojnë personin përgjegjës që do të shërbejë si pika kryesore e komunikimit me Ministrinë e Brendshme;

b) Të japin informacion për projektet e financuara nga Bashkimi Evropian dhe donatorë të tjerë për sektorin që mbulojnë, ku përfitues është bashkia;

c) Të analizojnë të dhënat specifike që dalin nga vlerësimi kombëtar i performancës së bashkive, lidhur me procesin e integrimit evropian, sipas sektorëve që mbulojnë.

6. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të ngrejë platformën elektronike intranet, të dedikuar për bashkitë, e cila do të shërbejë për ndarjen e praktikave më të mira, eksperiencave dhe informacionit mbi aktivitetet dhe çështjet e Bashkimit Evropian në bashki.

7. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministrinë e linjës dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**